REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 22/17
Datë/Datum. 24.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 22/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Blerim Dina - Kryetar, z. Goran Milenkovič – Referues, z.Nuhi Paçarizi – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Laguna" Sh.p.k - Prishtinë, kundër AK–/Ministria e Administratës Publike/, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë", me nr prok:"202/16/317/221", më datën 15.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "Laguna Sh.p.k" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë", me nr prok "202/16/317/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Administratës Publike/.

II. **Anulohet,** njoftimi për kontratë i AK-së /Ministria e Administratës Publike/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë", me nr prok:"202/16/317/221".

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "Laguna Sh.p.k "- Prishtinë, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 06.01.2017.

Kundër njoftimit për për kontratë, operatori ekonomik "Laguna Shpk" –Prishtinë me dt:18.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:20.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Laguna Shpk" –Prishtinë.

I pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Operatori ekonomik "Laguna" Sh.p.k - Prishtinë, ka deponuar ankesë në OSHP, më 23 janar 2017 me nr. 22/17, kundër njoftimit për kontratë me titull: "Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë", me nr prok:"202/16/317/221", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 22 i LPP-së – Inicimi i aktivitetit të prokurimit
- Neni 24 i LPP-së –Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
- Neni 111 i LPP-së –Arkivimi dhe përmbajtja thelbësore e Ankesës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.
Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 08 shkurt 2017, gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë", me nr prok:"202/16/317/221", i ka rekomanduar panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet e bazua, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj njoftimin për kontratë të datës: 06.01.2017 dhe ky aktivitet i prokurimit të anulohet.
Autoriteti Kontraktues me datë: 14 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Operatori ekonomik ankues "Laguna" Sh.p.k - Prishtinë, me datë: 09 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.02.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, përfaqësuesit e OJQ-së "Dplus"u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE "Laguna" ka deklaruar: "Ne si OE kemi deponuar ankesë në OSHP me nr.22/17, ne pajtohemi plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues sa i përket kësaj ankese. Dëshirojmë të konfirmojmë edhe njëherë që ky aktivitet i prokurimit ose ku njoftim për

kontratë, është në kundërshtim me nenin 22 dhe 24 të LPP-së, siç është inicimi i aktivitetit të prokurimit-zyrtarit të prokurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të prokurimit. Ky aktivitet është në fazën e rivlerësimit të ofertave me vendimin e OSHP-së nr.411/16 dh e413/16, 416/16 dhe 417/16. Ky aktivitet i prokurimit të cilin e ka iniciuar MAP, është i vendosur në Lot.10 të udhëhequr nga AQP. Edhe njëherë vlerësojmë se një aktivitet i prokurimit nuk mund të udhëhiqet në të njëjtën kohë nga dy AK. Si përfundim edhe njëherë kërkojmë nga OSHP që të aprovoj ankesën tonë dhe të anulohet njoftimi për kontratë nga AK-MAP derisa AQP të merr një vendim për këtë aktivitet të prokurimit i cili është në rivlerësim me vendim të OSHP-së. Si provë ia bashkangjes edhe interpretimin e KRPP për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MAP ka deklaruar: "AK-MAP e ka iniciuar këtë aktivitet duke u bazuar në nevojat e paraqitura për mirëmbajtjen e nevojave higjienoteknike për pallatin e drejtësisë. Këtë aktivitet MAP e ka udhëhequr duke u bazuar në njoftimin që është bërë nga ana e AQP për prokurimet e centralizuara. Këtë aktivitet AQP e ka iniciuar në vitin 2015, ku ende nuk ka arrit të nënshkruhet një kontratë për këtë pallat. MAP si përgjegjës për mirëmbajtje higjienoteknike të këtij pallati gjatë vitit 2016 ka zhvilluar dy procedura të negociuara. Me datë 30.12.2017 kemi marr një informatë nga AQP ku zhvillohet inicimi i një procedure për 12 muaj për pallatin drejtësisë. Gjithashtu është udhëzimi 02/2015 dhe 05/2016 për prokurimet qendrore të aprovuara nga Qeveria që i delegohen AQP, ku pika 3 thotë "të gjitha kontratat që i skadojnë AK-ve, munden me zhvillu një procedurë por jo më gjatë se 12 muaj". Mbi bazën këtyre kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe mendojmë se kemi bazë ligjore për zhvillim të këtij aktiviteti dhe kërkojmë që njoftimi jonë për këtë aktivitet të mbetet në fuqi".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Lidhur me pretendimet ankimore për inicimin e këtij aktiviteti të prokurimit, të publikuar në KRPP njoftimi për kontratë, mendoj dhe sqaroj se AK-MAP ka bërë shkelje të nenit 22 dhe 24 të LPP-së në fuqi. Kjo sepse i njëjti aktivitet nuk mund të iniciohet në njëjtën kohë në dy institucione pasi ky aktivitet është në fazën e rivlerësimit në AQP, që OSHP ka lëshuar vendim me nr.411-413-416-417/16. I rekomandoj panelit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të anulohet.

Në vazhdim Kryetari i panelit shqyrtues ka pyetur përfaqësuesin e AK se pasi konstatuat se janë hapur oferta te OE-ve, a ka konkurruar OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit?. Në përgjigje përfaqësuesi i AK-Së: "JO nuk ka dorëzuar ofertë OE tani ankues".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "Ne si OE kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-MAP, e çka është skandaloze nga MAP është se nuk ka pezulluar fare aktivitetin e prokurimit. Madje as nuk ka marr vendim për kërkesën tonë vetëm se është arsyetuar fillimisht me emali se ka marr leje nga AQP për të udhëhequr këtë aktivitet. Pastaj me 20.01.2017 ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, pa e bërë pezullimin e aktivitetit. Nuk di kush monitoron këta zyrtar të AK që bëjnë shkelje të tilla. Ne kemi dorëzuar ankesën prapë me afat edhe në OSHP, dhe AK-MAP serish nuk e ka pezulluar aktivitetin edhe pse ankesa ka qenë e protokollar në OSHP dhe pranë MAP, mirëpo ka vazhduar me dorëzimin e ofertave. Ne vendimin e OSHP-së e kemi pranuar pas hapjes së ofertave. Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj ankesën tonë dhe të anulohet njoftimit për kontratë nga MAP derisa AQP të merr një vendim për këtë aktivitet të prokurimit i cili është në fazën e fundit të rivlerësimit të ofertave.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe kërkojmë nga paneli shqyrtues të na lejoj të vazhdojmë me këtë aktivitet duke u bazuar në udhëzimet

02/2015 dhe 05/2016. OE ankues e ka atakuar procesin ku ne kemi pas njoftim për lejim të atij aktiviteti nga ana e AQP. OE i është shqyrtuar ankesa dhe i është dhënë vendim, dhe me datën e hapjes së ofertave OE "Laguna" ka bërë prapë ankesë pranë OSHP-së".
Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në ekspertizë".
Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedura dhe të gjitha sqarimet konstaton se autoriteti kontraktues e ka iniciuar këtë aktivitet të prokurimit përderisa procedura e hapur e njëjtë është duke u zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik dhe është në fazën e rivlerësimit, kurse në kuadër të kësaj procedure e cila është duke u zhvilluar nga AQP-ja për Lot 1 dhe 10 është i përshirë ky aktivitet që e ka iniciuar AK, prandaj nuk mund të zhvillohen dy procedura të hapura për të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe nuk mund të iniciohet një procedurë tjetër e hapur nga një institucion tjetër, përderisa AQP-ja gjendet në fazën e rivlerësimit të ofertave për aktivitetin e njëjtë të prokurimit sipas vendimit të OSHP-së me Nr.411/16, 413/16, 416/16, 417/16. Prandaj veprimi i autoritetit kontraktues nuk është në harmoni me nenin 22 dhe 24 të LPP-së, ku parashihen inicimet e aktiviteteve të prokurimit dhe personat përgjegjës për të zhvilluar këto aktivitete të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Bleriim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Administratës Publike"

1x1 OE – "Kompania e Pastrimit Laguna" Sh.p.k - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.